



RAPORTI VJETOR I ASOCIACIONIT NACIONAL TË AUTIZMIT NË KOSOVË (ANAK)

MARS 2023

MIRËNJOHJE

Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë (ANAK) dëshiron të falenderojë së pari prindërit dhe familjarët e fëmijëve me autizëm për besimin dhe angazhimin e tyre të palodhshëm në punën me fëmijët me autizëm. Gjithashtu, ANAK falenderon edhe institucionet e nivelit lokal dhe qendror të Kosovës, donatorët dhe bashkëpunëtorët e shumtë për mbështetjen e vazhdueshme në punën e organizatës për më shumë se dhjetë (10) vite rreth krijimit të kushteve të favorshme dhe të përshtatshme për personat me autizëm që të marrin shërbimet esenciale dhe garantimit të të drejtave dhe mundësive të barabarta si të gjithë pjesëtarët e tjerë të shoqërisë.

KLAUZOLË E PËRGJEGJËSISË

Publikimi i këtij raporti është bërë me iniciativë të Asociacionit Nacional të Autizmit në Kosovë (ANAK)

E DREJTA E AUTORIT

Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë (ANAK), mars 2023. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij raporti nuk mund të riprodhohet, ruhet në sistemin e rikuperimit ose të transmetohet në ndonjë formë ose me ndonjë mjet elektronik, mekanik, fotokopjim, regjistrim ose ndryshe, pa lejen paraprake të ANAK.

PUBLIKIMI I RAPORTIT

Ky raport është përpiluar nga Jeta Bakija, Drejtoreshë Ekzekutive e JB Consulting me mbështetje të ANAK.

PËRMBAJTJA

Fjala Hyrëse	06
Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë	07
Vizioni	
Misioni	
Objektivat Strategjike	
Informata të Përgjithshme rreth Autizmi	10
Angazhimi i ANAK në vitin 2022 dhe Rezultatet e Përgjithsme	12
Rezultatet konkrete në kuadër të projekteve specifike	
I. Shërbimi terapeutik për fëmijët me autizëm me sfida socio-ekonomike dhe mirëqenia e prindërve i financuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
II. Përmirsimi i mirëqënies së fëmijëve me autizëm duke ofruar shërbime multidisiplinare pa pagesë i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian dhe implementuar nga Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë në partneritet me Save the Children Kosova/o	
III. Integrimi funksional dhe kualitativ i fëmijëve me autizëm gjatë integritit dhe vetëdijësimit gjithpërfshirës i financuar nga Ministria e Arsimit, Shkenës, Teknologjisë dhe Inovacionit	
IV. Qëndrueshmëria e ofrimit të shërbimeve direkte ditore për fëmijët me autizëm dhe familjet e tyre i financuar nga Komuna e Prishtinës	
Iniciativa individuale dhe aktivitetet e tjera të ANAK	32
Shënimi i dhjetë (10) viteve punë të ANAK	
Art në Autizëm	
Për njëri tjetrin	
Sfidat për integrimin e fëmijëve me autizëm në shoqëri dhe sigurimin e mirëqenies së tyre	34
ANAK në vitet e ardhshme	35

Fjala Hyrëse

Çdo vit e më shumë, puna e përditshme direkte me fëmijë në ANAK ka treguar dhe, po tregon gjithmonë e më shumë, rezultate dhe përmirësim të prekshëm të cilësisë së jetës së fëmijëve, të cilën marrin terapi direkte ditore në qendrën e ANAK.

Përkushtimi i palëkundur i terapistëve, me kontributin shpirtëror e human, me kureshtje e durim e me shkathtësi analitike, tash e 11 vite e bëjnë zhvillimin dhe zgjerimin e ANAK edhe më të qëndrueshëm e të suksesshëm, duke rritur kështu edhe numrin e shërbimeve individuale.

Falenderim i veçantë i dedikohet prindërve të fëmijëve përfitues në ANAK, por edhe komunitetit në përgjithësi, me të cilët kemi ndarë së bashku kuptimin dhe pasqyrimin e gjendjes së fëmijëve të tyre, e më të cilët kemi përjetuar momente të paharruara, me përplot sfida dhe përparime funksionale. Në anën tjetër, i falenderoj të gjithë mbështetësit financiar, të cilët kanë arritur që t'a mirëmbajnë qëndrueshmërinë e një shërbimi të fokusuar në cilësi të matshme e përmbajtësore.



JETA DEVA

MA. SPEC PSIKOLOGE
KLINIKE
DREJTORE EKZEKUTIVE
ANAK

Duke pasur parasysh që nevojat janë të shumta në mungesë të shërbimeve stabile sociale, është e nevojshme mbështetja e secilit: qoftë si mbështetje e seancave të domosdoshme individuale të fëmijëve me sfida socio-ekonomike, apo duke u paraqitur si vullnetarë për asistentë të fëmijëve me autizëm gjatë procesit të integrit, duke mbështetur aktivitete të ndryshme rreth ngritjes së vetëdijësimit mbi autizmin, apo si avokim për realizim të të drejtave njerëzore të personave me nevoja të veçanta.

ASOCIACIONI NACIONAL I AUTIZMIT NË KOSOVË

Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë - ANAK, është organizatë joqeveritare e themeluar në janar 2012 me mbështetjen e profesorëve të Departamentit të Psikologjisë dhe Edukimit, në kuadër të së cilës është bërë i mundur ofrimi i shërbimeve individuale për fëmijët me autizëm me parimet themelore të terapisë së sjelljes dhe sjelljes verbale, si dhe është mundësuar trajnimi sistematik i familjeve të atyre fëmijëve.

Që nga themelimi i saj, ANAK prioritet të palëkundur ka cilësinë e terapisë individuale, me ç'rast fokusin e intervenimit e ka bazuar në principet e terapisë së Analizës dhe Aplikimit të Sjelljes dhe Sjelljes Verbale, si metoda të treguara shkencërisht efektive. Përveç terapisë direkte me fëmijët me autizëm, terapistët në baza ditore raportojnë verbalisht tek prindërit e fëmijëve, mbikëqyrin zhvillimin e fëmijëve, shqyrtojnë prioritetin e nevojave të fëmijëve, si dhe fusin të dhënat në sistemin e brendshëm shkencor E-Data në mënyrë longitutinale.

Për të realizuar dhe për të ndërlidhur zinxhirin e nevojave që një person me autizëm dhe familja e saj/tij e ka, ANAK në mënyrë të vazhdueshme ka ofruar: vlerësim klinik zhvillimor, plan individual të punës, trajnime të prindërve bazuar në planin individual të punës, shërbimin direkt profesional në baza ditore, konsulta të rregullta të prindërve si dhe konsulta të mësuesve në shkollë në rastet kur fëmija ka arritur të integrohet në sistemin e rregullt edukativ.

Përveç shërbimeve direkte profesionale, ANAK që nga thelemimi i saj ka kontribuar sistematikisht në vetëdijësim të shoqërisë mbi autizmin dhe shkathtësitë unike që mund t'i kenë, duke e mirëmbajtur një rrymë të vetëdijësimit pa viktimizim. Gjithashtu, në mënyrë të vazhdueshme ANAK bën influencimin dhe promovimin e vullnetarizmit si dhe avokimin institucional në betejën për të drejtat e personave me autizëm dhe familjet e tyre.

ANAK vazhdon të siguroj qëndrueshmërinë e saj më së shumti nga kontributet minimale të prindërve dhe profesionalizmi i stafit të saj, e në anën tjetër me ndihmën e donatorëve të ndryshëm arrin të i mbulojë edhe disa shpenzime dhe ofrim të shërbimeve shtesë dhe falas për fëmijët në kuadër të qendrës.

VIZIONI

Vizioni i ANAK është që të jap kontribut sistematik dhe cilësor për krijimin e kushteve të favorshme dhe të përshtatshme për personat me autizëm që të marrin shërbimet për të cilat kanë nevojë dhe kontribon që personat me autizëm të gëzojnë të drejtat dhe mundësitë të cilat i gëzojnë të gjithë pjesëtarët e tjerë të shoqërisë. ANAK do të punoj për një të ardhme ku të gjithë personat me autizëm marrin shërbime profesionale ditore dhe janë të pranuar dhe të respektuar në shoqëri.

**NJË SHOQËRI QË
U SIGURON JETË
CILËSORE DHE TË
DREJTA TË PLOTA
PERSONAVE ME
AUTIZËM**

MISIONI

ANAK synon përmbushjen e misionit të vet, përmes: ofrimit të shërbimeve direkte profesionale (vlerësimeve, shërbimeve direkte në baza ditore, konsultave profesionale, etj); integritit e gjithëpërfshirjes (asistenca në integrimin e fëmijëve me autizëm në sistemin edukativ dhe në përgjithësi në sistemin shoqëror); ofrimit të trajnimeve (organizimi i trajnimeve dhe punëtorive për profesionistë dhe prindër të fëmijëve me autizëm); përkthimeve (përkthime të vazhdueshme të literaturës mbi autizmin, metodat e përdorura për punë me rastet e autizmit dhe materiale tjera relevante lidhur me autizmin); hulumtimeve (hulumtime të vazhdueshme mbi numrin e personave me autizëm, shërbimet ekzistuese dhe të nevojshme si dhe çështje tjera që lidhen me autizmin); publikimeve (publikim të raporteve në baza vjetore dhe të materialeve tjera me rëndësi për autizmin); kampanjave vetëdijësuese (konferenca për media, fletëpalosje, dokumentarë, etj); avokimit (bashkëpunimi me insitucione relevante në nivel qeveritar dhe jo qeveritar për ngritje të kapaciteteve të shërbimeve për autizëm) dhe aktiviteteve tjera relevante.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

ANAK ka këto objektiva strategjike:

- Ofrimi i shërbimeve profesionale terapeutike;
- Integrimi dhe gjithpërfshirja;
- Avokimi;
- Edukimi;
- Menaxhim efektiv dhe efikas i organizatës;
- Qëndrueshmëria.

ANAK zhvillon programe dhe projekte duke i marrë parasysh të gjitha objektivat e përmendura, ku aktivitetet specifike të cilat zbatohen, kontribuojnë në arritjen e tyre. Fokusi kryesorë i ANAK është ofrimi i shërbimeve profesionale direkte terapeutike për personat me autizëm dhe familjarët e tyre. Tutje, ANAK punon vazhdimisht në integrimin dhe përfshirjen e personave me autizëm në sistemin e rregullt edukativ dhe punon në ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve dhe profesionistëve të ardhshëm rreth autizmit dhe personave me autizëm, si dhe avokon rreth krijimin të kushteve dhe mundësive më të mira për personat me autizëm dhe familjet e tyre.

ANAK punon vazhdimisht në krijimin e qëndrueshmërisë së organizatës duke investuar në menaxhimin efektiv dhe efikas të saj si dhe në ngritjen e mundësive për fonde dhe mbështetje financiare të programeve dhe projekteve të cilat krijohen në bazë të nevojave të paraqitura nga puna e përditshme e ANAK.

INFORMATA TË PËRGJITHSHME RRETH AUTIZMIT

Autizmi është çrregullim neurobiologjik që veçohet me vështirësi në komunikim, ndërveprim shoqëror dhe me sjellje të përsëritura e rreze të kufizuara interesimesh. Personat me autizëm që nga mosha e hershme e fëmijërisë ballafaqohen me sfida të ndërlidhura direkt me vëshirësitë e komunikimit, e cila mund të ketë si rrjedhojë zhvillimin e sjelljeve problematike nga pamundësia që fëmija të kuptojë perceptimin e të tjerëve. Situata rëndohet edhe më shumë kur fëmija arrinë moshën e adoleshencës, duke rritur kërkesat e tij/saj me sjelljet insistuese drejt realizimit të kërkesave, e në të njëjtën kohë në Kosovë nuk ka asnjë shërbim kullativ apo kuantitativ për të rriturit me autizëm, si dhe nuk mbështeten financiarisht për nevojat e tyre të shumta.

Edhe pse sistemi arsimor në Kosovë e ka të obligueshme që të zbatoj ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës për inkuadrim të fëmijëve me autizëm brenda sistemit të rregullt edukativ, prindërit e fëmijëve me autizëm sistematikisht kanë sfida në procesin e inkuadrimin të fëmijëve të tyre, duke filluar me problemin praktik të mungesës së asistentëve individual në baza të rregullta. Në mungesë të kushteve ekonomike për të paguar asistentë, ndodh që prindërit të detyrohen të ndërpresin shkollimin e fëmijëve të tyre, apo të asistojnë vet fëmijën e tyre në klasë. Ky është një reflektim i një zgjidhje ende simbolike të shtetit në raport me ligjin ku ofron të drejta, por, ende nuk ka zgjidhje institucionale të qëndrueshme dhe funksionale për fëmijët në nevojë.

DISA NGA SFIDAT DHE VËSHIRËSITË ME TË CILAT PËRBALLEN FËMIJËT ME AUTIZËM JANË:

Vështirësi në ndërveprim social

- Mungesë e interesimit për të zhvilluar miqësi me të tjerët;
- Mungesë e kontaktit me sy;
- Nuk tregojnë shprehje të gëzimit, suksesit apo arritjeve të tyre tek të tjerët;
- Kanë perceptim tjetër të kuptimit të gjendjes emocionale të të tjerëve si: gëzimin, dhimbjen, humorin, lojën etj.

Vështirësi në komunikim

- Në disa raste karakterizohen me vonesë në të folur ose fëmija ka thënë disa fjalë dhe rreth moshës 2-3 vjeçare fillon që mos të l përsërit më;
- Mungesë e iniciativës për fillim të bisedës apo parashtrim të pyetjeve;
- Ndonjëherë ka mungesë të komunikimit verbal duke përdorur fjalë me kuptim, apo vështirësi në komunikim jo verbal të nevojave të veta tek të tjerët, p.sh me gjuhë trupore;
- Mungesë e interesimit për pranim të kërkesave nga të tjerët;
- Përsëritje fjalësh jashtë kontekstit, si fjalë nga një reklamë televizive.

Sjellje përsëritëse dhe interesim të theksuar në gjëra specifike

- Lëvizje përsëritëse trupore si përplasje/lëkundje të duarve, rrotullim të objekteve, luajtje me gishta, rrotullim rreth vetes etj;
- Fiksim në shkronja, numra, pjesë objektesh, renditje të objekteve/ngjyarave etj;
- Përsëritje tingujsh të njejtë;
- Fokusim të tepruar në detaje të gjërave përreth duke anashkaluar tërësinë dhe funksionin e tyre;
- Nevojë të theksuar për një trajtshmëri dhe rutinë – ndalje në të njejtin dyçan, të kaloj në të njëjtën rrugë, të dëgjoj të njëjtën pjesë të këngë/videos, të shikon ambiente me kënde, të jetë shumë përzgjedhë në emra, ushqime, ngjyra etj.

ANGAZHIMI I ANAK NË VITIN 2022 DHE REZULTATET E PËRGJITHSHME


Gjatë vitit 2022, ANAK ka zbatuar gjithsejt katër (4) projekte të cilat kishin për qëllim ofrimin e shërbimeve profesionale dhe shërbimeve të tjera për personat me autizëm dhe familjarët e tyre. Projektet të cilat janë zbatuar përgjatë vitit 2022, janë:

1. Shërbimi terapeutik për fëmijët me autizëm me sfida socio-ekonomike dhe mirëqenia e prindërve i financuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
2. Përmirsimi i mirëqënies së fëmijëve me autizëm duke ofruar shërbime multidisiplinare pa pagesë i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian dhe implementuar nga Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë në partneritet me Save the Children Kosova/o;
3. Integrimi funksional dhe kualitativ i fëmijëve me autizëm gjatë integrimit dhe vetëdijësimit gjithpërfshirës i financuar nga Ministria e Arsimit, Shkenës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
4. Qëndrueshmëria e ofrimit të shërbimeve direkte ditore për fëmijët me autizëm dhe familjet e tyre i financuar nga Komuna e Prishtinës.

Si përfitues direkt gjatë vitit 2022 nga zbatimi i aktiviteteve të ndryshme nga ANAK në kuadër të projekteve të lartpërmendura, janë regjistruar gjithsejt 80 fëmijë dhe 160 prindër të fëmijëve me autizëm. Tutje, institucionet të cilat kanë përfituar në formë direkte dhe indirekte nga zbatimi i aktiviteteve të ndryshme në kuadër të programeve dhe projekteve të ANAK janë:

1. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
2. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
3. Departamenti i Mirëqenies Sociale, Komuna e Prishtinës;
4. Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës;
5. Departamenti i Psikologjisë, Universiteti i Prishtinës;
6. Shkollat të cilat i ndjekin fëmijët me autizëm;
7. Kopshtet të cilat kanë fëmijë me autizëm.

Gjatë vitit 2022, ANAK me anë të organizimit të aktiviteteve të ndryshme ka regjistruar më shumë se 776 persona si përfitues direkt. Përfituesit direkt të ndarë në kategori, janë të paraqitur në grafikunin 1.



GRAFIKONI 1: NUMRI I PËRFITUESVE DIREKT GJATË VITIT 2022

Me anë të krijimit të kampanjave të ndryshme gjatë vitit dhe shpërndarjes së informatave rreth aktiviteteve të organizuara në webfaqe të ANAK dhe në rrjetet sociale të Facebook dhe Instagram kemi arritur të kemi audiencë prej më shumë se 300,000 persona.

Më shumë informata rreth ANAK dhe aktiviteteve të cilat zbatohen në kuadër të programeve dhe projekteve të ndryshme, ju lutem vizitoni webfaqen në www.autizmi.org, faqen zyrtare në Facebook Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë dhe Instagram anak.2012.

REZULTATET KONKRETE NË KUADËR TË PROJEKTEVE SPECIFIKE

1

Shërbimi terapeutik për fëmijët me autizëm me sfida socio-ekonomike dhe mirëqenia e prindërve i financuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Qëllimi kryesor i projektit ishte të kontriboj në rritjen e disponueshmërisë, cilësisë dhe qëndrueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të nevojshme sociale për fëmijët me autizëm dhe familjarët e tyre, duke u fokusuar tek ata të cilët kanë kushte të vështira socio-ekonomike. Qëllimi kryesor i këtij projekti është krijimi i një sistemi cilësor të shërbimeve sociale dhe familjare për personat me autizëm dhe familjarët e tyre. Objektivat specifike të projektit ishin:

- Rritja e cilësisë së shërbimeve profesionale familjare për fëmijë dhe adoleshentë me autizëm;
- Ofrimi i këshillimit dhe vazhdimit të punës në shtëpi, përkrahjes psiko-sociale, përkujdesjes në shtëpi dhe shërbimeve të tjera për fëmijë dhe adoleshentë me autizëm.
- Trajnim i asistentëve dhe konsulta të rregullta mbi inkuadrimin dhe integrimin në kopshte dhe shkolla.
- Ofrimi i këshillimeve, përkrahjes psikosociale, terapisë logopedike, ergoterapisë, përkujdesjes, vetë-ndihmës, mbështetjes së njëri-tjetrit dhe shërbimeve të tjera përkatëse për fëmijët dhe adoleshentët me autizëm.

Në kuadër të këtij projekti, përveç aktiviteteve të tjera, ANAK ka bërë publikimin e raportit final të projektit i cili përmban informata rreth autizmit; zhvillimin e fëmijëve që kanë marrë ndihmë direkte nga zbatimi i këtij projekti, së bashku me prezantimin e rezultateve konkrete duke shpjeguar procesin e zhvillimit në bazë të të dhënave të mbledhura në E-data Plus; gjetjet nga mbështetja terapeutike për prindërit; dhe rekomandimet që do të përdoren edhe si dokument avokues drejtuar institucioneve publike dhe mund të përdoren nga profesionistët që punojnë në këtë fushë. Raporti është publikuar në gjuhën shqipe dhe është shpërndarë në ëebfaqen dhe rrjetet sociale të ANAK dhe mund të gjindet në webfaqen e ANAK në www.autizmi.org.

Një prej aktiviteteve të parapara në kuadër të këtij projekti, është ofrimi i pakos esenciale e shërbimit terapeutik, ku si qëllim kishte vlerësimin dhe matjen e nevojave për intervenim që fëmija aktualisht i ka në zhvillimin e tij/saj. ANAK ka bërë përzgjedhjen e shtatë (7) familjeve për të përfutur nga ky projekt, familje të cilat kishin kushte të vështira socio-ekonomike të shkaktuara nga COVID-19. Pako esenciale terapeutike e ofruar pa pagesë ka përfshirë këto shërbime:

- Vlerësimin

Në vlerësim të fëmijës me autizëm, janë ftuar të dy prindërit ose kujdestari bashkë me fëmijën. Gjatë periudhës 1 orë e 30 minuta, është bërë observimi i fëmijës, ndërsa prindërit janë përgjigjur në pyetjet që personi përgjegjës për vlerësim i u ka bërë atyre për zhvillimin e fëmijës, bazuar në instrumentin matës për sjellje adaptive Vineland, si dhe në bazë të testeve direkte dhe intervenue me fëmijën.



Përveç pyetjeve të vpyetësorit, është shtuar edhe pjesa e historikut të zhvillimit të fëmijës që nga shtatëzania e deri në moshën aktuale të fëmijës. Pjesa narrative dhe matjet e kombinuara nga procesi i vlerësimit, janë përshkruar në planin individual të fëmijës.




- Planin individual terapeutik

Plani individual terapeutik përshkruan të dhënat e mbledhura nga procesi i vlerësimit të fëmijës duke përfshirë gjithmonë edhe analizën e sjelljeve sfiduese dhe problematike. Objektivat e punës të përshkruara në planin individual të fëmijës me autizëm, u janë bashkangjitur edhe instruksionet se si duhet mësuar secila objektivë.

- Trajnimin për prindërit

Pas përpilimit të planit individual terapeutik, prindërit janë lajmëruar dhe janë ftuar në trajnim i cili është organizuar vetëm për prindërit, kujdestarët apo familjarët e tjerë të cilët jetojnë bashkë me fëmijën me autizëm dhe janë trajtuar përkitazi objektivave të shkruara në plan. Plani individual terapeutik i përpiluar nga stafi profesional i drejtuar nga specialisti klinik në ANAK, ka mundësuar që metodat e punës të rekomanduara të vazhdojnë edhe në punë me fëmijën me autizëm në ambiente të shtëpisë nga prindërit, familjarët apo kujdestarët e këtyre fëmijëve.



Në kuadër të këtij projekti, gjithsejt janë organizuar 384 seanca terapeutike për shtatë (7) fëmijë me autizëm, apo një (1) seancë në javë për një (1) fëmijë.


Gjatë seancave terapeutike, terapistët kanë përdorur terapinë e Analizës së Aplikuar të Sjelljes dhe Terapisë Verbale të përshtatur edhe me terapinë e lojës, varësisht prej karakteristikave individuale të fëmijës. Analizës së Aplikuar të Sjelljes dhe Terapisë Verbale ka trajtuar çështjet e komunikimit, shkathtësive motorrike dhe çrregullimin e sjelljes të fëmijëve me autizëm, përfitues direkt të këtij projekti. Në kuadër të seancave

terapeutike, gjithashtu janë organizuar edhe aktivitete grupore të cilat kanë shërbyer në socializim, në adaptim të sjelljeve dhe bashëpunim grupor e cila lidhet me njërin prej fushave të vështirësive tek fëmijët me autizëm siç është socializimi.

Terapistët e angazhuar, kanë përgatitur dhe dorëzuar raportin individual të zhvillimit të fëmijës për të cilët ata kanë qenë përgjegjës duke shpjeguar mbarëvajtjen e punës, metodat intervenuese dhe rekomandimet lidhur me objektivat e caktuara.


Nga organizimi i këtij aktiviteti, kanë përfituar në formë direkte shtatë (7) fëmijë dhe katrëmbëdhjetë (14) prindër. Gjithashtu, si përfitues të këtij aktiviteti janë edhe familjarët e tjerë që jetojnë me fëmijë me autizëm.

Përfituesit direkt të pakos esenciale të shërbimit terapeutik, të moshës 2 – 12 vjet, të ndarë në gjini janë paraqitur në grafikonin 2.




GRAFIKONI 2: FËMIJËT ME AUTIZËM PËRFITUES TË PAKOS ESENCIALE TË SHËRBIMIT TERAPEUTIK, TË MOSHËS 2 – 12 VJET, TË NDARË NË GJINI.

Përfituesit direkt të pakos esenciale të shërbimit terapeutik, të moshës 2 – 12 vjet, të ndarë sipas vendlindjes janë paraqitur në grafikonin 3.




GRAFIKONI 3: FËMIJËT ME AUTIZËM PËRFITUES TË PAKOS ESENCIALE TË SHËRBIMIT TERAPEUTIK, TË MOSHËS 2 – 12 VJET, TË NDARË SIPAS VENDLINDJES.

Përfituesit direkt të pakos esenciale të shërbimit terapeutik, prindër të fëmijëve me autizëm, të ndarë sipas gjinisë, janë paraqitur në grafikoni 4.




GRAFIKONI 4: PRINDËR TË FËMIJËVE ME AUTIZËM, PËRFITUES TË PAKOS ESENCIALE TË SHËRBIMIT TERAPEUTIK, TË CILËT TË NDARË SIPAS GJINI.

Përfituesit direkt të organizimit të seancave terapeutike, të moshës 4 – 8 vjet, të ndarë në gjini janë paraqitur në grafikoni 5.




GRAFIKONI 5: FËMIJËT ME AUTIZËM PËRFITUES TË ORGANIZIMIT TË SEANCAVE TERAPEUTIKE, TË MOSHËS 4 – 8 VJET, TË NDARË NË GJINI.

Përfituesit direkt të organizimit të seancave terapeutike, të moshës 4 – 8 vjet, të ndarë sipas vendlindjes janë paraqitur në grafikoni 6.




GRAFIKONI 6: FËMIJËT ME AUTIZËM PËRFITUES TË ORGANIZIMIT TË SEANCAVE TERAPEUTIKE, TË MOSHËS 4 – 8 VJET, TË NDARË SIPAS VENDLINDJES.

Përfituesit direkt të organizimit të konsultave me prindër, të ndarë sipas gjinisë, janë paraqitur në grafikoni 7.



GRAFIKONI 7: PRINDËR TË CILËT KANË PËRFITUAR NGA ORGANIZIMI I KONSULTAVE, TË NDARË SIPAS GJINISË.

Përfituesit direkt të organizimit të konsultave me prindër, të ndarë sipas komunës nga vijnë, janë paraqitur në grafikoni 8.



GRAFIKONI 8: PRINDËR TË CILËT KANË PËRFITUAR NGA ORGANIZIMI I KONSULTAVE, TË NDARË SIPAS KOMUNËS NGA VIJNË.

Nga organizimi i konsultave si pjesë e këtij projekti, tre (3) prej prindërve kanë përfituar nga ofrimi i konsultave ekstra, të bazuara në nevojën e paraqitur e dalë nga vlerësimi i fëmijës.

Stafi profesional i ANAK i cili ka punuar direkt me fëmijët me autizëm, në kuadër të këtij projekti, kishte mundësi që ngarkesat emocionale, dilemat mbi përdorimin e praktikave terapeutike, mbështetjen profesionale ta ndaj me personin përgjegjës për mbikqyrje të punës terapeutike në kuadër të ANAK. Mbikqyrësi i punës terapeutike, gjatë periudhës tetë (8) mujore, ka monitoruar seancat terapeutike individuale; ka dhënë rekomandime me shkrim dhe verbale në lidhje me specifikat e paraqitura nga obzervimi ose kërkesat e terapistëve; ka mbikqyrë procesin e futjes së të dhënave të fëmijëve që përfitojnë nga ky projekt në E-Data Plus; dhe ka dhënë rekomandime në formë të shkruar në lidhje me intervenimin në sjellje. Gjithashtu, mbikqyrësi i punës terapeutike ka qenë përgjegjës edhe për mbajtjen e trajnimit me prindër.


Tutje, ANAK ka organizuar gjithsejt dymbëdhjetë (12) takime individuale me prindër ku është diskutuar rreth gjendjes së tyre emocionale dhe qasjes dhe kontributit të tyre në përmirësimin e mirëqenies së fëmijës. Nga organizimi i këtyre takimeve, nga personi i angazhuar profesional psikiatër I fëmijëve dhe adoleshentëve, kanë përfituar gjashtë (6) prindër me nga një (1) takim dhe tre (3) prindër me nga dy (2) takime. Me anë të organizimit të konsultave me prindër, ANAK ka arritur të e zvogëlojë barrë e terapistëve duke fuqizuar prindërit me anë të ofrimit të mbështetjes emocionale dhe diskutimeve në grupe me qëllim të ndarjes së përvojave të ndryshme të familjarëve të cilët kanë fëmijë me autizëm.

Prindërit që kanë përfituar nga organizimi i konsultave individuale dhe grupore, janë rekomanduar gjithashtu të i përmbahen objektivave të prezantuara në planet individuale të përpiluara gjithashtu në kuadër të këtij projekti dhe të i zbatojnë ato edhe në ambientet e tjera me fëmijët e tyre.

Duke e marrë parasysh që mbikëqyrja e jashtme është një domosdoshmëri e parimeve thelbësore për punën psikoterapeutike, ku përmes reflektimit të brendshëm nga terapistët, ata përforcojnë mekanizmat mbrojtës për përballimin e situatave të ndryshme sfiduese, duke lehtësuar marrëdhëniet me prindërit e fëmijëve me autizëm dhe për të shmangur subjektivitetin në trajtimin e rasteve, ANAK në kuadër të këtij projekti është angazhuar person profesional e cila ka organizuar dymbëdhjetë (12) seanca në grup dhe individuale për mbikëqyrje për personelin e ANAK.

Përfituesit direkt të organizimit të seancave të supervizionit, të ndarë sipas gjinisë, janë paraqitur në grafikonin 9.





GRAFIKONI 9: TERAPISTËT TË CILËT KANË PËRFITUAR NGA ORGANIZIMI I SEANCAVE TË SUPERVISIONIN PËR PERSONELIN. TË NDARË SIPAS GJINISË.

Gjithsejt dymbëdhjetë (12) takime me personelin janë organizuar, ku katër (4) prej tyre kanë qenë takime grupore dhe tetë (8) prej tyre kanë qenë takime individuale. Me anë të organizimit të takimeve me personelin, ANAK ka arritur që përmes reflektimit personal, të sigurohet që situatat të cilat shkaktojnë ngarkesa emocionale të trajtohen nga një kënd tjetër jashtë ngarkesës ditore dhe sygjerime objektive për menaxhimin e stresit në punë dhe përmirësimin e gjendjes emocionale të çdo terapisti të ANAK-së janë ofruar. Organizimi i seancave të supervizionit për personelin është bërë nga një psikolog klinik profesional i angazhuar në kuadër të këtij projekti.

ANAK gjithashtu ka krijuar një bibliotekë për stafin, ku libra të fundit mbi zhvillimin e fëmijëve, metodat intervenuese shkencërisht efektive, dhe njohuri të tjera rreth ushqyerjes, stresit, dhe metodave relaksuese për fëmijë dhe të rritur janë blerë. Gjithashtu, blerja e tabletëve dhe funksionalizimi i dhomës sensorike e ka bërë më të lehtë punën me fëmijë dhe ka zhvilluar dimensione të tjera terapeutike në punën e përditshme me prindër dhe fëmijë.

Tutje, është mundësuar krijimi i hapësirave të reja për punë profesionale dhe profilizim të objektivave punuese. Ndër këto hapësira është krijuar biblioteka për fëmijë dhe stafin profesional të ANAK me artikuj të fundit shkencor mbi metodat punuese për fëmijë me autizëm. Gjithashtu, është bërë blerja e dy (2) ipad të cilët janë përdorur në mësimin e objektivave edukativo-arsimore dhe ngritjen e kapaciteteve të fëmijëve në përdorimin e teknologjisë për qëllim të mësimin dhe përdorim sa më produktiv.


Posedimi i dhomës sensorike në ANAK, për herë të parë është zhvilluar si mjedis i krijuar posaçërisht për të ofruar një përvojë ndijësore gjithëpërfshirëse, tek fëmijët që marrin shërbim direkt në ANAK. Stimulimet e ndryshme, duke përfshirë stimulimet vizuale përmes dritave, llampave, reflektorëve të ndryshëm, do të jenë mundësi e qëndrueshme për të promovuar fokusimet vizuale të fëmijëve, e në anën tjetër, kjo dhomë mund të përdoret edhe si

shpërblyes për zhvillim të komunikimit.

Poashtu, stimulimet auditive, përmes transmetimit të melodive të ndryshme, të cilat shpesh herë shoqërohen tek stereotipitë senzomotorike tek personat me autizëm, mund të japin efekte të theksuara pozitive në relaksim dhe filtrimin e mbindjeshmërive nga zhurmat e ndryshme. Më këtë rast është mundësuar përfshirja edhe e terapisë muzikore në ANAK.

Gjithashtu, me krijimin e këndit për stimulime taktile, të cilat dijnë të jenë të shprehura shumë në stereotipet senzomotorike tek personat me autizëm, është mundësuar hapësira me materiale të ndryshme, të cilat mund të zhvendosin disbalancin e ndjeshmërive të të prekurit, e të cilat stimuj mund të parandalojnë edhe akumulimin drejt sjelljeve problematike të fëmijëve.

Rëndësia e dhomave sensorike mbështetet edhe shkencërisht për përdorimin e tyre me fëmijët në spektrin e autizmit, të cilat krijohen për të pasur një efekt qetësues, që redukton ankthin dhe përmirëson fokusin.



2

Përmirësimi i mirëqënies së fëmijëve me autizëm duke ofruar shërbime multidisiplinare pa pagesë i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian dhe implementuar nga Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë në partneritet me Save the Children Kosova/o

Qëllimi kryesor i projektit është të ofrojë shërbime esenciale për fëmijët me autizëm dhe familjet e tyre të cilët jetojnë në të gjitha komunat e Kosovës, veçanërisht familjet që kanë fëmijë me autizëm që janë prekur më së shumti nga Covid19, duke u ofruar pa pagesë “Pako Esenciale” e cila përfshin vlerësimin psikologjik, përpilimin e detajuar të planit individual, trajnimin e prindërve për zbatimin e objektivave dhe mënyrat specifike intervenuese, mbajtjen e seancave terapeutike individuale, dhe konsulta sistematike të prindër. Gjithashtu një nga pikat


me rëndësi në një qasje më complete shumëdisiplinare është vazhdimi i shërbimeve logopedike dhe terapeutike pa pagesë për të gjithë fëmijët që marrin shërbime në ANAK, pasi që nga matja e nevojave të familjeve, ka rezultuar që rreth 50% e fëmijëve marrin shërbim tek logopedët dhe asistentët privat me pagesë shtesë.

Objektivat specifike të projektit ishin:

- Ofrimi i shërbimeve profesionale ditore për fëmijët me autizëm, familjet e të cilëve janë prekur më shumë nga situata e krijuar për shkak të pandemisë COVID-19;
- Ri-mundësimi i ekipës multidisciplinare me seanca logopedike dhe terapeutike pa pagesë për të gjithë fëmijët që marrin shërbime në organizatë;
- Mirëmbajtja e shërbimeve për autizëm pas Covid 19 dhe ruajtja e cilësisë së shërbimeve për autizëm në Kosovë.

Objektivat e paraqitura në këtë projekt janë implementuar me metoda të bazuara në evidencë shkencore përmes bashkëpunimit të profesionistëve të organizatës nën mbikqyrje profesionale në ofrimin e shërbimeve kompakte për fëmijët me autizëm të cilat kanë lehtësuar barrën financiare duke i ofruar këto shërbime pa pagesë.

Me anë të ofrimit të shërbimeve esenciale cilësore terapeutike pa pagesë në kuadër të projektit kanë përfituar gjithsej katrëmbëdhjetë (14) fëmijë. Përfituesit direkt të shërbimeve esenciale cilësore terapeutike pa pagesë të ndarë në gjini janë paraqitur në grafikoni 10.



GRAFIKONI 10: FËMIJËT, PËRFITUES DIREKT TË SHËRBIMEVE ESENCIALE CILËSORE TERAPEUTIKE PA PAGESË TË NDARË NË GJINI.

Grupmoshat e fëmijëve të cilët ishin përfitues direkt të këtij projekti janë:

- **Dy (2) vajza të moshës 5 dhe 8 vjeçare; dhe**
- **Njëmbëdhjetë (11) djemë të grupmoshave 2 -10 vjeç**


Gjatë fazës së zbatimit të këtij projekti, janë organizuar gjithsejt 374 seanca terapeutike pa pagesë. Implementimi i punës terapeutike është bazuar në parimet dhe teknikat e Analizës së Aplikuar të Sjelljes (ABA), metodë kjo e vërtetuar shkencërisht si efektive. Gjatë seancave të para, është ofruar trajnim i vazhdueshëm për prindërit, të cilët kanë marrë rekomandime në lidhje me trajtimin dhe mbështetjen e fëmijës së tyre me autizëm si dhe mënyrën e zbatimit të objektivave dhe teknikat specifike në lidhje me nevojat e paraqitura nga prindërit si dhe teknikat terapeutike dhe intervenuese në sjellje.




Janë mbajtur gjithsej shtatëdhjetë e dy (72) konsulta sistematike profesionale me prindër ku janë diskutuar teknikat e vazhdimin të punës në shtëpi si dhe është bërë dhënia e rekomandimeve specifike në lidhje me nevojat e paraqitura nga prindërit si dhe teknika terapeutike dhe intervenuese në sjellje. Progresi konkret i fëmijëve është regjistruar në platformën E-data për secilin hap të objektivave të cilat janë punuar me fëmijët përfitues.

ANAK në kuadër të konsultave me akterë bashkëpunues në implementimin e pikave të planit individual të fëmijëve me autizëm ka ofruar rekomandime specifike të intervenimit në klasë mësimdhënëses së njërit prej fëmijëve me autizëm. Tutje, janë mbajtur tri (3) konsulta profesionale me njëren prej asistentet e cila punon me njërin prej fëmijëve me autizëm në shkollë.

Nga organizimi i seancave logopedike dhe terapeutike pa pagesë, kanë përfituar gjithsejt njëzet e pesë (25) fëmijë me autizëm. Fëmijë përfitues të ndarë sipas gjinisë dhe moshës janë prezantuar në grafikoni 11 dhe 12, respektivisht.



GRAFIKONI 11: FËMIJËT, PËRFITUES DIREKT TË ORGANIZIMIT TË SEANCAVE LOGOPEDIKE DHE TERAPEUTIKE.



GRAFIKONI 12: GRUPMOSHA E PËRFITUESVE TË SEANCAVE LOGOPEDIKE DHE TERAPEUTIKE

Para hartimit të planeve individuale për fëmijët përfitues të këtij projekti, janë mbajtur konsulta me prindër për të marrë më shumë informacione rreth gjendjes së fëmijës në fushën e komunikimit. Gjithsejt janë zhvilluar tetëmbëdhjetë (18) plane individuale, të cilat janë bazuar në nevojat e fëmijëve, duke caktuar objektivat e punës. Caktimi i objektivave të punës për secilin fëmijë kanë kontribuar në realizimin e seancave të frytshme të cilat kanë sjellë rezultate pozitive të përmirësimit tek fëmijët me autizëm. Planet individuale për secilin fëmijë janë rishikuar cdo tre (3) muaj, dhe janë reviduar sipas nevojës dhe progresit të fëmijës.


Para hartimit të planeve individuale për fëmijët përfitues të këtij projekti, janë mbajtur konsulta me prindër për të marrë më shumë informacione rreth gjendjes së fëmijës në fushën e komunikimit. Gjithsejt janë zhvilluar tetëmbëdhjetë (18) plane individuale, të cilat janë bazuar në nevojat e fëmijëve, duke caktuar objektivat e punës. Caktimi i objektivave të punës për secilin fëmijë kanë kontribuar në realizimin e seancave të frytshme të cilat kanë sjellë rezultate pozitive të përmirësimit tek fëmijët me autizëm. Planet individuale për secilin fëmijë janë rishikuar cdo tre (3) muaj, dhe janë reviduar sipas nevojës dhe progresit të fëmijës.

Gjithsejt, janë organizuar 100 seanca logopedike në muaj për tetëmbëdhjetë (18) fëmijë përfitues, të cilat kanë sjellur sukses.




I gjithë procesi terapeutik është monitoruar dhe vlerësuar nga personi përgjegjës i mbikqyrjes së punës terapeutike e cila përveç pjesës së seancave, vlerësimeve, rivlerësimeve, qëllim kryesor ka pasur konsultat dhe trajnimet e prindërve të rinj dhe dhënien e përcjelljen e progresit/regresit të secilit fëmijë në organizatë. Seancat terapeutike të cilat kanë pasur nevojë më emergjente për rekomandime specifike janë analizuar nga mbikqyrësi i punës terapeutike dhe janë marrë rekomandimet për vazhdimin e përdorimit të intervenimit të caktuar.

Nga objektiva e rivlerësimeve kanë përfituar gjithsejt tridhjetë e katër (34) fëmijë me autizëm. Fëmijët me autizëm, përfitues të procesit të rivlerësimeve të ndarë në gjini dhe grupmosha, janë të paraqitur në grafikoni 13 dhe grafikoni 14, respektivisht.




GRAFIKONI 13: FËMIJËT NGA ORGANIZIMI I RIVLERËSIMEVE TË NDARË NË GJINI.




GRAFIKONI 14: GRUPMOSHA E PËRFITUESVE TË RIVLERËSIMEVE

Nga objektiva e mbikqyrjes terapeutike kanë përfituar gjithsejt katërdhjetë e tre (43) fëmijë me autizëm. Fëmijët me autizëm, përfitues të mbikqyrjes terapeutike të ndarë në gjini dhe grupmosha, janë të paraqitur në grafikoni 15 dhe grafikoni 16, respektivisht.



GRAFIKONI 15: FËMIJËT PËRFITUES TË MBIQYRJES TERAPEUTIKE TË NDARË NË GJINI.



GRAFIKONI 16: GRUPMOSHAT E FËMIJËVE TË CILËT KANË PËRFITUAR NGA MBIQYRJA TERAPEUTIKE

Tutje, nga organizimi i aktiviteteve të mbikqyrjes terapeutike, përfitues direkt janë regjistruar edhe dhjetë (10) persona, staf i organizatës ANAK, ku nëntë (9) prej tyre ishin të gjinisë femërore dhe një (1) ishte i gjinisë mashkullore.

Nga ofrimi i pakos esenciale pa pagesë për fëmijët me autizëm e cila ka përmbajtur vlerësimin klinik dhe hartimin e pikave individuale të plantit kanë përfituar në formë direkte tre (3) fëmijë të gjinisë mashkullore, ndërsa janë trajnuar pesë (5) prindër prej të cilëve tri (3) të gjinisë femërore dhe dy (2) të gjinisë mashkullore, të gjithë mbi 25 vjeç.

3

Integrimi funksional dhe kualitativ i fëmijëve me autizëm gjatë integrimit dhe vetëdijësimit gjithpërfshirës i financiar nga Ministria e Arsimit, Shkenës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Qëllimi i këtij projekti ishte përmirësimi i cilësisë së procesit të integrimit të fëmijëve me autizëm në sistemin e rregullt edukativ në çerdhe dhe shkolla të ndryshme të Kosovës.

Objektivat specifike të projektit ishin:

- Përbushja kualitative e procesit të integrit të fëmijëve me autizëm dhe nevoja tjera të veçanta, duke intervenuar përmes metodave të Analizës dhe Aplikimit së Sjelljes (AAS);
- Ngritja e vetëdijës përmes video animacioneve dhe simboleve konkretizuese, mbi karakteristikat e personave me autizëm për qasjet e përshtatshme dhe pranimin e tyre më të lehtë në komunitet.

Gjatë periudhës së zbatimit të këtij projekti, ANAK ka përfshirë gjithsejt tridhjetë e tetë (38) fëmijë nga këto komuna: Prishtinë, Gjakovë, Ferizaj, Vushtrri, Mitrovicë, Prizren, Fushë Kosovë dhe Suharekë. Nga tridhjetë e tetë (38) fëmijët, përfitues direkt të këtij projekti, njëmbëdhjetë (11) prej tyre nuk kishin asistentë, nëntë (9) prej tyre kishin asistentë me pagesë dhe dy (2) prej tyre si asistentë kishin nënat e tyre në institucionet edukative.

Tutje, nga zhvillimi i trajnimeve me edukatorë, mësimeve si dhe asistentë individual të fëmijëve me autizëm dhe persona të tjerë të cilët janë të përfshirë në procesin e integrit në komunitet, kanë përfituar në formë direkte gjithsejt 509 persona, të cilët kanë qenë nga rajone të ndryshme të Kosovës. Organizimi i këtyre trajnimeve ka kontribuar në ngritjen e njohurive dhe kapaciteteve të pjesëmarrësve në lidhje me mënyrën praktike përmes qasjeve të ndryshme të bazuara në metodat shkencore të Analizës së Sjelljes, për adaptimin dhe përmirësimin e sjelljeve sfiduese të fëmijëve me autizëm brenda sistemit të rregullt edukativ.



Në kuadër të këtij projekti, me qëllim të ngritjes së vetëdijës përmes videoanimacioneve dhe simboleve konkretizuese mbi karakteristikat e personave me autizëm për qasje më të përshtatshme dhe pranimin e tyre në komunitet, ANAK ka publikuar dy (2) videoanimacione. Publikimi i këtyre dy (2) videoanimacioneve është bërë për herë të parë në Kosovë. Videoanimacionet janë publikuar në të gjitha gjuhët e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, siç janë: gjuha serbe, turke, rome dhe angleze dhe mund të i gjeni në webfaqen e ANAK dhe në rrjetet sociale të organizatës në Facebook dhe Instagram.

ANAK gjatë periudhës së zbatimit të këtij projekti, ka vazhduar lobimin për shërbimet esenciale

dhe profesionale, përmes hapave të drejtpërdrejtë të angazhimit të asistentëve individual për fëmijët me autizëm.


Përfituesit direkt të këtij projekti kanë qenë personat me autizëm dhe familjarët e tyre, vullnetarët, stafi i ANAK, të rinjtë pjesëmarrës në aktivitetet vetëdijësuese të organizuara në kuadër të këtij projekti si dhe qytetarët e Kosovës në përgjithësi. Përfituesit direkt kanë qenë kryesisht të gjinisë femërore, përderisa mosha ka qenë nga 3 vjet deri në 55 vjet. Paraqitjet e shumta në media me qëllim të ngritjes së vetëdijes rreth të drejtave të fëmijëve me autizëm dhe rëndësisë së ofrimit të mundësisve të barabarta, ka ndikuar të rritet numri i përfituesve të këtij projekti.

Më poshtë janë paraqitur përfituesit e aktiviteteve specifike të organizuara në kuadër të këtij projekti.

TRAJNIMI ME SHKOLLA



Nga organizimi i trajnimit me përfaqësues të shkollave, kanë përfitur gjithsej njëzet e gjashtë (26) persona. Shkollat fillore të cilat kanë përfitur direkt nga organizimi i këtij trajnimi janë: Ismail Qemali (Prishtinë), Faik Konica (Prishtinë), Musa Hoti (Mitrovicë) dhe Agim Ramadani (Zhegër, Gjilan). Nga njëzet e gjashtë (26) pjesëmarrës, dy (2) kanë qenë edukatorë të mësimit parafillorë, tetë (8) kanë qenë arsimtarë të klasave nga XI deri IX, njëmbëdhjetë (11) kanë qenë mësuese të ciklit të ulët, një (1) kanë qenë pedagog, dhe tre (3) kanë qenë asistente mbështetëse. Të gjithë pjesëmarrësit në trajnim kishin gjithsej katërmbëdhjetë (14) fëmijë me autizëm dhe një (1) me sindromë Down në klasët e tyre. Nga katërmbëdhjetë (14) fëmijë, vetëm katër (4) prej tyre e kishin të hartuar Planin Individual të Arsimit (PIA).



GRAFIKONI 17: PJESËMARRËSIT E NDARË NË GJINI

KONSULTIMET E ASISTENTËVE INDIVIDUAL TË FËMIJËVE GJATË PROCESIT TË INTEGRIMIT

Nga organizimi i konsultimeve individual të fëmijëve gjatë procesit të integrimit përmes hapave konkret, kanë përfituar gjithsejt tridhjetë e nëntë (39) fëmijë me autizëm të moshës 2 – 15 vjet.

TRAJNIMI ME STUDENTË TË DEPARTAMENTIT TË PSIKOLOGJISË, UNIVERSITETI I PRISHTINËS

ANAK ka organizuar trajnim me studentë të Departamentit të Psikologjisë, Universiteti i Prishtinës, ku nga pesëdhjetë e pesë (55) pjesëmarrës, katërdhjetë e tetë (48) ishin studentë të nivelit Bachelor në Psikologji të Përgjithshme, gjashtë (6) prej tyre ishin nga niveli Master në Psikologji Shkollore dhe Këshillim dhe një (1) profesor i Departamentit të Psikologjisë. Nga pesëdhjetë e pesë (55) pjesëmarrës, katërdhjetë e tetë (48) ishin të gjinisë femërore dhe shtatë (7) ishin të gjinisë mashkullore.


TRAJNIMI ME STUDENTË TË DEPARTAMENTIT TË PSIKOLOGJISË, UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Në kuadër të prezantimeve të “Alumni”, ANAK ka organizuar trajnim me studentë të Departamentit të Psikologjisë, Universiteti i Prishtinës, ku nga katërdhjetë gjashtë (46) pjesëmarrës, tridhjetë e tetë (38) prej tyre ishin të nivelit Bachelor në Psikologji të Përgjithshme, shtatë (7) ishin të nivelit Master të Psikologjisë Shkollore dhe Këshillim dhe një (1) ishte profesor i Departamentit të Psikologjisë. Nga katërdhjetë e gjashtë (46) pjesëmarrës, katërdhjetë e dy (42) ishin të gjinisë femërore dhe katër (4) ishin të gjinisë mashkullore.

TRAJNIME PËR ASISTENTË, EDUKATORË DHE MËSIMDHËNËS

ANAK ka organizuar trajnime për asistentë, edukatorë dhe mësime dhënë, të cilët janë të përfshirë në procesin e integritit të fëmijëve me autizëm në procesin edukativ. Nga 509 pjesëmarrës nga të gjitha rajonet e Kosovës, 484 prej tyre ishin të gjinisë femërore dhe njëzet e pesë (25) ishin të gjinisë mashkullore.

Shpërndarja e profesioneve të pjesëmarrësve është përshkruar në grafikoni 18.



GRAFIKONI 18: PJESËMARRËSIT E NDARË SIPAS PROFESIONEVE.

KONSULTA INDIVIDUALE RRETH PROCESIT TË INTEGRIMIT TË FËMIJËVE ME AUTIZËM

ANAK ka organizuar gjithsejt 209 konsulta individuale lidhur me sfidat e procesit të integritit të fëmijëve me autizëm. Nga 209 konsulta të organizuara, 102 prej tyre u janë ofruar për asistentë të fëmijëve me autizëm përmes metodës së obzervimit dhe këshillimit individual kurse 107 janë ofruar për prindërit të fëmijëve me autizëm lidhur me sfidat e ndryshme të cilat ata i hasin gjatë procesit të integritit të fëmijëve të tyre në sistemin e rregullt edukativ.

Nga organizimi i këtyre konsultave kanë përfituar:

- Nëntëmbëdhjetë (19) asistentë individual nga këto komuna: Prishtina, Gjlani, Suhareka, Gjakova, Prizreni, Istogu, Kaçaniku, Mitrovica dhe Fushë Kosova. Pjesëmarrësit kanë përfituar nga obzervimi i seancave direkte terapeutike apo nga konsultat individuale në raport me nevojat e tyre gjatë procesit të integritit të fëmijës me autizëm në sistemin edukativ.
- Njëzet e tetë (28) edukatore janë konsultuar direkt lidhur me vështirësitë specifike të fëmijëve me autizëm të cilët janë në proces të integritit në sistemin edukativ.

- Tre (3) prindër të fëmijëve me autizëm, të cilët poashtu e luajnë edhe rolin e asistentëve personal të fëmijëve gjatë procesit të integrimin, janë konsultuar në baza sistematike.

Gjatë kohës së konsultimeve sistematike të asistentëve nga terapistët e ANAK, ndryshimet konkretet të fëmijëve kanë qenë në këto fusha: adaltime në kopsht/shkollë, ndjekja e rutina në klasë, socializimi/bashkëveprimi me fëmijë tjerë, adaptime në ushqime, në pavarësimin e toaletit etj.

4

Qëndrueshmëria e ofrimit të shërbimeve direkte ditore për fëmijët me autizëm dhe familjet e tyre i financuar nga Komuna e Prishtinës

Në kuadër të këtij projekti, ANAK e ka mbuluar pagesën mujore të qirasë së shtëpisë e cila shfrytëzohet për të ofruar shërbime profesionale dhe të tjera për fëmijët me autizëm dhe prindërit dhe familjarët e tyre. Mbështetja financiare e komunës ka qenë për periudhë gjashtë (6) muaj.

INICIATIVA INDIVIDUALE DHE AKTIVITETET E TJERA TË ANAK

SHËNIMI I DHJETË (10) VITEVE PUNË TË ANAK

Në vitin 2022 ANAK ka shënuar dhjetë (10) vjetorin e themelimit të saj. Për të prezantuar punën dhe sukseset e arritura gjatë dhjetë (10) viteve, ANAK ka organizuar një konferencë ku janë ftuar të gjithë bashkëpunorët, udhëheqësit e institucioneve, shoqërinë civile, profesorë të fakulteteve, profesionistë të fushave të ndryshme shëndetësore, prindër dhe donatorë që kanë mbështetur organizatën në rrugëtimin e saj. Në këtë konferencë është prezantuar raportin i publikuar i ANAK i cili ka përshkruar punën e organizatës, aktivitetet specifike dhe arritjet ndër vite. Raporti në gjuhën shqipe mund të gjindet në webfaqen e ANAK në www.autizmi.org.



ART NË AUTIZËM

ANAK pikë me fokus të vecantë ka edhe aktivitetet dhe kampanjat që promovojnë pikat e forta të personave me autizëm dhe mbështetjen e tyre pa viktimizim. “Art në Autizëm” 2022 program i pikturës mbështetur nga NLB BANKA ka lansuar ekspozitën e saj më 01 Qershor, 2022 në Biblotekën Kombëtare me pikturat e punuara nga fëmijët me autizëm e që aktualisht ndodhen në shitje në platformën e Joy from GjirafaMall.



PËR NJËRI TJETRIN

Në kuadër të festave të fundvitit organizata për të tretin vitë rradhazi ka lansuar kampanjën “Për njëri tjetrin” qëllimi i së cilës ishte shitja e produkteve, paratë e të cilave mbështesin rastet me kushte më të vështira ekonomike me nga një seancë në java pa pagesë. Vetëm gjatë vitit 2022 nga kjo kampanjë janë mbajtur 422 seanca terapeutike pa pagesë e në të cilat kanë përfituar 20 fëmijë.



SFIDAT PËR INTEGRIMIN E FËMIJËVE ME AUTIZËM NË SHOQËRI DHE SIGURIMIN E MIRËQENIES SË TYRE

Nga procesit i zhvillimit të projektit dhe nga vështirësitë e dalura, është vërejtur nevoja për përfshirjen e teknikave të Analizës dhe Aplikimit të Sjelljes, në kuadër të lëndëve zgjedhore/obligative gjatë studimeve në departamentin e Psikologjisë, Edukimit dhe Punëve Sociale.

Disa nga sfidat të cilat pengojnë integrimin e fëmijëve me autizëm në shoqëri, sigurimin e mirëqenies së tyre si dhe sfidat me të cilat përballen familjarët e fëmijëve me autizëm, të identifikuar gjatëpunës së ANAK në vitin 2022 janë:

- Mungesa e mbështetjes financiare afatgjate e cila garanton qëndrueshmëri për organizatën; rrjedhimisht, ofrimin e shërbimeve cilësore terapeutike për fëmijët me autizëm dhe familjarët e tyre;
- Mungesa e mbështetjes financiare nga donatorë të ndryshëm për tejkalimin e sfidave me të cilat organizata është përballur, sidomos rreth krijimit të infrastrukturës dhe paisjeve adekuate të nevojshme për trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve për personat me autizëm;
- Mungesa e mjeteve kualitative pedagogjike dhe rekreative;
- Mungesa e mbështetjes institucionale në krijimin e infrastrukturës adekuate për trajtimin dhe mbështetjen e fëmijëve me autizëm dhe familjarët e tyre;
- Mungesa e mbështetjes institucionale në ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve dhe edukatorëve rreth autizmit dhe metodave adekuate efektive të trajtimit të personave me autizëm;
- Sistem i pa organizuar në shërbimet e duhura sociale;
- Mungesa e kushteve të trajtimit të adoleshentëve me autizëm;
- Mungesa e gatishmërisë së institucioneve publike dhe private rreth integritit të personave me autizëm specifikisht, krijimin e vendeve të punës.

ANAK NË VITET E ARDHSHME

ANAK synon për të informuar institucionet dhe shoqërinë në përgjithësi mbi origjinalitetin e personave me autizëm, talentet e tyre unike, nevojat për shërbime dinjitoze, dhe për të avokuar mbi pabarazinë e të drejtave të tyre, karshi një mos funksionimi të duhur politik, ekonomik e shoqëror në Kosovë. Hapat avokues të ANAK fokusohen në shqyrtimet dhe përmbushjet e fushave të mëposhtme:

Ligji Gjithpërfshirës

Pjesë e programit avokues të ANAK është edhe angazhimi rreth përpilimit të “Projektligjit dhe Raportit final për Projektligjin për Vlerësimin, Njohjen e Statusit, Përfitimet dhe Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuar”, i cili do të kontribuojë edhe më shumë në një stabilitet financiar nga burimet shtetërore për personat me autizëm e veçanërisht për familjet e tyre. Ligji i ri për shërbime sociale dhe familjare, ka për qëllim adresimin e nevojave për ekipë multidisiplinare nëpër institucione relevante edukative, e veçanërisht për sistemimin e psikologëve në qendrat për punë sociale.

Ofrimi i pakos esenciale falas

ANAK është duke punuar fuqishëm që për të gjithë fëmijët me sfida socio-ekonomike në Kosovë, të jetëson ofrimin e shërbimeve falas me “PAKO ESENCIALE”, e cila përfshinë: vlerësimin individual (për secilin fëmijë me autizëm apo të dyshuar me autizëm), shkrimin e planeve individuale të punës, trajnimin e secilës familje në mënyrë specifike për procedurat e ndërhyrjes, si dhe seanca të rregullta javore terapeutike me fëmijën, të shoqëruara me konsulta të rregullta të familjarëve të tyre. Arritja e këtij modeli social, synohet të bëhet përmes subvencionimit të shërbimeve nga institucionet publike si dhe nga sponsorizimi stabil dhe afatgjatë i kompanive, bankave apo bizneseve të ndryshme. Me funksionimin stabil të pakos esenciale, ANAK do të vazhdoj avokimin duke prezantuar këtë sistem tek Qeveria e Kosovës dhe institucionet përgjegjëse dhe do të krijoj plane dhe strategji stabile afatgjate, drejt mundësisit të shërbimit direkt për secilin fëmijë në Kosovë pa asnjë diskriminim.

Qëndrim ditor për personat me autizëm mbi 18 vjeç

ANAK do të avokoj për krijimin e një qëndrimi ditor për personat me autizëm që janë të moshës madhore, mbi 18 vjeç. Qëndrimi ditor propozohet të ofroj aktivitete që stimulojnë potencialin e

tyre drejt pavarësimit dhe angazhimit në gjëra praktike, të cilat mund të zhvillojnë mundësi për punësim varësisht nga aftësitë apo sjelljet e tyre stereotipet/të përsëritshme.

Mundësimi i asistentëve individual pa pagesë

ANAK, me mbështetje financiare nga donatorë të ndryshëm, planifikon të mbulojë pagesën e asistentëve individual të fëmijëve me autizëm që janë në proces të integritit në kopshte dhe shkolla dhe që kanë sfida të natyrës socio-ekonomike.

Monitorim sistematik i asistentëve mbështetës

ANAK do të punoj rreth krijimit të një komisioni profesional dhe etik, i cili do të ketë rol për të mbikëqyrur asistentët që punojnë me fëmijët brenda sistemit të rregullt edukativo-arsimor në Kosovë, dhe për të rishikuar progreset/sfidat e fëmijëve me autizëm në gjithë procesin.

Sigurimi i ekipës multidisciplinare gjatë procesit të diagnozave përmes sigurimeve shëndetësore

Bazuar në sfidat e theksuara të prindërve në rast të dyshimeve të familjarëve lidhur me zhvillimin e fëmijëve të tyre, është e nevojshme që të mundësohet krijimi i një ekipe diagnozuese i përbërë nga psikiatër i fëmijëve dhe pediatër në kopshte dhe shkolla.

Ngritja e vetëdijes dhe kompanjat avokuese

ANAK vazhdimisht ka avokuar dhe avokon që Qendrat për Punë Sociale që të kenë të ndara kategoritë që do të menaxhojnë rastet që paraqiten nga qytetarët e Kosovës, përfshirë edhe personat me autizëm. Kjo është e domosdoshme për sistemin e njohurive dhe referimeve adekuate dhe specifike si dhe për qasje të duhur për shërbime sociale dhe për zgjidhjen praktike të vështirësive që familjet e personave me autizëm hasin.

Zhvillimi i metodologjive dhe moduleve profesionale

ANAK planifikon të fokusohet në zhvillimin e metodologjive dhe moduleve profesionale të avancuara, të cilat njëkohësisht do të përmbushin mungesën serioze të literaturës dhe prezantimeve profesionale interveuese në gjuhën shqipe.

ANAK ka për qëllim të punoj drejt integritit konkret të fëmijëve me autizëm në sistemin e rregullt edukativ përmes studentëve të psikologjisë dhe edukimit, me ç'rast obligimin e kryerjes së praktikës ta zhvendosin zyrtarisht në obligim të përkushtuar dhe zyrtar duke i asistuar direkt fëmijët me autizëm. Kjo objektivë do të mundësojë një ndryshim konkret nëpërmes: integritit individual të fëmijës, ku prindi nuk do të paguante asistent për fëmijën; studentët e përkushtuar do të krijonin përvojë të njohur/zyrtare pune; dhe Komuna do të realizonte obligimin e saj për

shkollim cilësor dhe gjithpërfshirje.

Krijimi i mundësive për punësim

ANAK do të krijojë mundësi për personat me autizëm të përfitojnë nga ofrimi i programeve për zhvillim të zanateve, shprehjeve artistike apo për zhvillim të kapaciteteve të ndryshme të tyre. Kjo mënyrë krijon mundësinë për përgatitjen e personave me autizëm të jenë konkurent në tregun e punës. Gjithashtu, ANAK është në proces të rritjes së vetëdijësimit të kompanive dhe insitucioneve në Kosovë, lidhur me aftësitë e rralla që personat me autizëm mund t'i kenë dhe mundësitë për punësimin e tyre

Këtë objektivë ANAK e ka synim që deri në vitin 2023 t'a arrijë duke bashkëpunuar me institucione të vendeve të zhvilluara dhe me institucione/kompani lokale, biznese të ndryshme etj.

Mbështetje online pa pagesë

ANAK ka synim që deri në vitin 2026, të krijoj një degëzim të një Linje Telefonike të Ndhmës për familjet, shkollat, kopshtet, dhe komunitetin e gjerë, të cilët do të ketë mundësinë për qasje në informata bazike për autizmin, shërbimet e nevojshme apo informata tjera të ndërlidhura me të drejtat e personave me autizëm.

